

NEWSLETTER E DIASPORËS

PËRFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE TË NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT,
DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

#46

Qendra e Botimeve për Diasporën takim me mësuesit e gjuhës shqipe në Itali



Qendra e Botimeve për Diasporën në bashkëpunim me Lidhjen e Mësuesve në Itali organizuan takimin e parë në Rexho Emilia (Reggio Emilia) me mësuesit e gjuhës shqipe. Më datë 7 shkurt Drejtoresha e Qendrës së Botimeve znj. Mimoza Hysa si dhe drejtuesja e Lidhjes së Mësuesve në Diasporë znj. Ariana Kosova morën pjesë në një orë të hapur pranë shkollës shqipe "Shqiponja". QBD-ja shpërndau paketat e abetareve për nxënësit e kësaj shkolle. Më datë 8 shkurt u organizua një takim me rreth 100 mësues të gjuhës shqipe të ardhur nga krahinat e ndryshme të Italisë ku morën pjesë dhe konsulli i Shqipërisë në Milano, konsulli i Kosovës në Romë, konsulli i Kosovës në Milano, përfaqësues të Organizatës Italiane të Emigracionit si dhe të shumë organizatave dhe shoqatave shqiptare. Drejtoresha e Qendrës së Botimeve për Diasporën prezantoi punën e këtij institucioni, projektet ne proces në ndihmesë të mësimdhënies në diasporë, si dhe paketën e librave plotësues të siguruar prej tij. Në vijim u bë një diskutim të hapur rreth problematikave të mësuesve në diasporë, si: hartimi i teksteve të reja për mësimin në diasporë, kriteret e regjistrimit të mësuesve në regjistrin zyrtar të mësuesve, hapja e bibliotekave të librit shqip pranë komunave në vendin ku jetojnë etj. Në përfundim të takimit u shpërndanë paketat me 11 libra të sigurara nga QBD-ja, si dhe u ftuan mësuesit të janë të pranishëm në Takimin Mbarëkombëtar të Mësuesve të Diasporës në Tiranë më 14 mars.

Drejtoresha ekzekutive e FSHZHD- së pjesë e eventit "Çmimet e Filantropisë 2019"



Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, i përfaqësuar nga Drejtoresha Ekzekutive znj. Blerina Turdiu u bë pjesë e eventit "Çmimet e Filantropisë 2019" organizuar nga "Partners Albania for Change and Development" në Shqipëri. Gjatë eventit janë ndarë disa çmime të filantropisë për kontribut në nivel kombëtar, në nivel lokal, për kontributin si individ dhe për kontributin në angazhim social. Fitues i një ndër çmimeve të filantropisë për vitin 2019 ishte edhe sipërmarrësi shqiptar Altin Prenga, i kthyer nga emigracioni shumë vite më parë e që sot ka një biznes agroturizmi në zonën e Lezhës.

KKD / Anëtarët në akademinë përkujtimore të Mikel Kuzhninit



Anëtarët e Këshillit Koordinues të Diasporës, z. Sokrat Sinaj dhe z. Lazim Destani morën pjesë në akademinë përkujtimore të gjashtëmujorit të ndarjes ngajeta të bashkëthemeluesit dhe Kryetarit të Nderit të Lidhjes Shqiptare në Botë, Mikel Kuzhninit. Kjo veprimtari u zhvillua në qytetin Langenthal të Zvicrës me pjesëmarrjen e personaliteteve dhe Diasporës shqiptare në Zvicër.

Drejtoresha ekzekutive e FSHZHD- së pjesë e aktivitetit të organizuar nga GIZ dhe CIM



Drejtoresha Ekzekutive e Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës znj. Blerina Turdiu mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga GIZ dhe CIM në qytetin e Elbasanit. Në aktivitet u prezantua projekti "Hap pas hapi", rritja ekonomike e grave në rajonin e Elbasanit përmes shkëmbimit të njohurive me Diasporën shqiptare në Gjermani. Znj. Turdiu informoi mbi veprimtarinë e institucionit, projektet në zbatim të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës dhe ecurinë e zbatimit të tyre.


KKD / Gazmend Kapllani kumtesë në Michigan



Join us at the 5th Annual GKS Fund Gala
THE PALAZZO GRANDE
FEBRUARY 8th 2020 | 7pm-12am
Buy Tickets Now at www.gksfund.org

Anëtarë i Këshillit Koordinues të Diasporës dëshkimi i njohur Gazmend Kapllani do të kumtojë fjalën hyrëse në Mbrëmjen Gala të organizatës "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" (GKS) në Michigan të SHBA-së. Prej vitesh, GKS jep bursa për studentë shqiptarë që të studojnë në universitetet amerikane.

Aplikacioni informues "Diaspora Shqiptare"



App store [këtu](#) Play store [këtu](#)

"Rapoço" problemi në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#) Play store [këtu](#)

Për të kontribuar në ndihmë të familjeve të prekura nga tërmeti



Kontributet vullnetare dhe ndihmat për familjet, mund të bëhen me shpejtësi në rrugë digitale, në tre kategoritë e veçanta të hapura për grumbullimin e ndihmave në portalin "e-Albania".

KKD / Gazmend Kapllani kumtesë në Michigan



Join us at the 5th Annual GKS Fund Gala
THE PALAZZO GRANDE
FEBRUARY 8th 2020 | 7pm-12am
Buy Tickets Now at www.gksfund.org

Anëtarë i Këshillit Koordinues të Diasporës dëshkimi i njohur Gazmend Kapllani do të kumtojë fjalën hyrëse në Mbrëmjen Gala të organizatës "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" (GKS) në Michigan të SHBA-së. Prej vitesh, GKS jep bursa për studentë shqiptarë që të studojnë në universitetet amerikane.

